

## KONTRIBUTI I ELEMENTËVE TË EDUKIMIT MJEDISOR DHE VLERËSIMI I METODAVE NXITËSE PËR RUAJTJEN E LIDHJES SË NXËNËSIT ME NATYRËN

\*ALLA E.<sup>1</sup>, QIRJO M.<sup>1</sup>, KUQO F.<sup>2</sup>

<sup>1</sup>Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Biologjisë

<sup>2</sup>Ministria e Arsimit dhe Sportit

e-mail: [erjona.alla@fshn.edu.al](mailto:erjona.alla@fshn.edu.al)

### Përmbledhje

Natyrë është vendi ku ne jetojmë, është një laborator i gjallë që ofron mundësi për ta njohur e kuptuar përmes edukimit dhe zhvillimit të njohurive (Sanderson, 2009). Ky studim është një përpjekje për të përmirësuar të kuptuarin tonë rreth shkallës së lidhjes me natyrën me qëllim plotësimin e edukimit të nxënësve për natyrën si vendbanim, kulture, edukimi, çlodhje dhe argëtimi, në mënyrë që jeta e tyre të jetë më e plotë dhe më e pasur. Studimi ka si qëllim të evidentojë elementët e edukimit mjedisor që nxisin lidhjen e nxënësve me natyrën dhe t'i pasurojë tekstet dhe programet mësimore në sistemin arsimor bazë me këto elementë. Objektivat specifike të tij janë vlerësimi i lidhjes së nxënësit me natyrën, nxitur prej programeve mësimore në AMU dhe vlerësimi i aktiviteteve më efektive që e nxisin këtë lidhje me natyrën. Studimi u krye në vitin 2015 dhe përfshiu 23 shkolla, prej të cilave 14 në zonat urbane dhe 9 në zona rurale, të shtrira në 10 rrethe të vendit. Përmes pyetësorëve, janë grumbulluar mendimet e 2500 individëve të lidhur me këtë nivel të sistemit arsimor drejtorë, mësues, nxënës dhe prindër. Nga analiza e programeve të lëndëve mësimore klasa 1-9 rezulton se kemi një tendencë jo lineare të përfshirjes së objektivave të edukimit mjedisor për të nxitur nxënësit në njohjen e botës së gjallë dhe forcimin e lidhjes së tyre me mjedisin. Nxënësit e shkollave të përfshira në studim, vlerësohen të kenë lidhje të pakët me natyrën duke shpenzuar më shumë kohë në mjedise të mbyllura. Kjo lidhje zëvendësohet nga mënyra të tjera të mbushjes së kohës së lirë si lidhja me botën digjitale, lojërat më pak të pastrukturuara në natyrë dhe elementet e lidhur me urbanizimin të tilla si harxhimi i kohës në qendrat tregtare, bare, etj. Duke njohur pasojat në edukim dhe shëndet prej humbjes së lidhjes me natyrën, nevojitet të kemi një proces mësimor më aktiv, të rinovuar në përmbajtje e në formë dhe tërheqës drejt elementeve mjedisore. Këto duhet të gjejnë shprehje konkrete përmes përdorimit të metodave e teknikave mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, që përçojnë në nivelin e duhur vlerat e lidhjes me natyrën përmes aktiviteteve të ndryshme.

### Abstract

Nature, the place we live in, is a living laboratory that offers possibility to be known and understood through education and knowledge development. This study is an effort to improve our understanding of preserving the connection with nature in order to educate students regarding nature as a habitation, cultural, education and entertainment place for

their life to be fuller and richer. The study aims to examine and enrich the elements of environmental education that promote the connection with nature through its coverage in textbooks and school programs in the educational system. Its specific objectives are evaluating the connection of the students with nature, driven by school programs of AMU and evaluating the most efficient activities that result in this connection. The study took place in 2015 and it involved 23 schools, 14 of which were located in urban areas and the other 9 in rural areas, lying in 10 regions of the country. The opinions of 2500 people related to this level of the education system (principals, teachers, students and parents) were gathered through this questionnaire. From the analysis of the teaching curricula (grade 1-9) it results that a non linear tendency of including the environmental education objectives exists to encourage students to get to know more about the living world and its interdependence with the environment. The students of the schools included in the study, turned out not to have a real connection with nature, spending more time indoors. This connection is replaced with other ways of spending free time like the connection with the digital world, indoor games and urbanization related elements such as spending time in commercial centers, bars etc. Knowing the consequences in health and education coming from the lack of connection with nature, a more active, renovated in content and form and attractive to environmental elements curricular process is needed. It needs to use contemporary, comprehensive and interactive methods in order to convey in the right level the values of the connection with nature through different activities.

**Fjalëkyçe:** edukim mjedisor, lidhja nxënës - natyrë, mjedise të mbyllura, bota digjitale, urbanizimi, aktivitetet ekstrakurrikulare.

### **Hyrje**

Shkolla përmes programeve mësimore, të cilat vlerësohen si bazë në zhvillimin intelektual e social të nxënësit dhe nëpërmjet veprimtarive të zhvilluara në lëndë të ndryshme ndihmon nxënësit të njihen me natyrën, të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe ruajtjen e saj duke përdorur me efikasitet burimet natyrore (IKS, 2007). Edukimi në këtë drejtim fillon që me fillimin e shkollimit, në familje, shoqëri e komunitet.

Ajo i aftëson nxënësit të zhvillojnë me frytshmëri kuriozitetin, kërkimin, krijimin, mendimin e pavarur e kritik për mbrojtjen e natyrës dhe të shëndetit (IKS, 2007). Qëllimi i Edukimit Mjedisor si lëndë kroskurrikulare synon që të gjithë nxënësit të vlerësojnë dijet dhe përvojat e tyre individuale për rritjen e respektit ndaj natyrës, si dhe përfshirjen e tyre në veprimtari praktike për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të saj (Deklarata Tbilisi, 1977) referuar në konferencën e parë për edukimin mjedisor. Ndërsa jemi duke folur në lidhje me edukimin mjedisor do të ishte me interes të përmendim që sot ky term ka pasur një evolucion drejt gjithëpërfshirjes. Sot, në fakt shihet një zhvendosje nga Edukimi

Mjedisor në Edukim për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Në bashkëpunim me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe Arsimin për të gjithë, Dekada e Edukimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm (2005- 2014) u propozua nga UNESCO, duke nënkuptuar se arsimi është sektori kritik për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Lidhja me natyrën ka të bëjë me qëndrimet dhe besimet afatgjata dhe jo një qëndrim afatshkurtër apo ndjenjë të ngrohtë që e kemi përjetuar pas një dite që kemi qëndruar jashtë në natyrë. Kur të rinjtë janë të lidhur me natyrën, ka ndikime pozitive në edukimin e tyre, shëndetin fizik, mirëqenien emocionale, aftësitë personale duke i ndihmuar ata të bëhen qytetarë të përgjegjshëm. Të rinjtë e sotëm janë shumë më pak të lidhur me botën natyrore se në çdo kohë tjetër në histori (Levin, D., Arafeh, S. (2002).

Duke vlerësuar që Edukimi Mjedisor në vendin tonë është lëndë kroskurrikulare, nëpërmjet programeve të lëndëve të ndryshme të klasave 1-9, nxënësit kanë mundësi të shqyrtojnë dhe të diskutojnë çështje mjedisore të rëndësishme për komunitetin e tyre. Kurrikula i krijon mundësi mësuesit që elementët mjedisor t'i përzgjedhin në kushtet që i ofron mjedisi gjeografik. Kjo bën të mundur që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet e nevojshme mjedisore për të marrë në të tashmen dhe të ardhmen vendime të rëndësishme e të përgjegjshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit (Bajrami D., Zenelaj F. (2008)

Studimi ka si qëllim të shqyrtojë dhe të propozojë pasurimin e teksteve dhe programeve mësimore në sistemin arsimor bazë me elementë të edukimit mjedisor që nxisin lidhjen e nxënësve me natyrën. Objektivat specifike të tij janë njohja e shkallës së lidhjes natyrë – nxënës, vlerësimi i metodave të mësimdhënies që nxisin dhe përforcojnë këtë lidhje duke rritur ndjeshmërinë për problemet e mjedisit human dhe natyror, si dhe aftësinë për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve komplekse mjedisore.

### **Materiali dhe metodat**

Vlerësimi i shkallës së lidhjes së nxënësit me natyrën dhe nivelit sa kjo lidhje nxitet në kuadër të edukimit mjedisor si lëndë kroskurrikulare, është kryer përmes teknikës së intervistimit të drejtpërdrejtë mbi bazën e pyetësorëve specifikë. Grupi i synuar ka përfshirë individë të lidhur më Arsimin e Mesëm të Ulët (klasa 5-të dhe 9-të), i përbërë prej 2500 individësh, nga të cilët 40 drejtorë/nëndrejtorë të shkollave, 231 mësues (66 të ciklit fillor dhe 157 të ciklit të mesëm të ulët), 1143 nxënës (561 të klasës së 5-të dhe 582 të klasës së 9-të ) dhe 1086 prindër të tyre. Përzgjedhja e mostrës së shkollave dhe individëve të intervistuar të marrë në vlerësim është bërë në mënyrë rastësore me synimin të jetë gjeografikisht përfaqësuese e vendit. Fillimisht janë përzgjedhur 10 DAR (DAR) dhe ZA (Zyra Arsimore) me numrin më të lartë të nxënësve. Brenda secilit rreth të mbuluar nga DAR dhe ZA e përzgjedhur, janë përcaktuar 2

shkolla, specifikisht një në zonë urbane dhe një në zonë rurale. Numri i përgjithshëm i shkollave të përzgjedhura ishte 23 shkolla (9 në zona rurale, dhe 14 në zona urbane). Në përzgjedhjen e DAR dhe ZA nuk janë ndjekur kritere përmbajtësore përzgjedhjeje apo përjashtimi, meqë kemi ndjekur logjikën se, lidhur me sistemin arsimor, nuk ka rajone, qytete apo fshatra më përfaqësues se të tjerët, por të gjithë ndjekin të njëjtat orientime strategjike arsimore. Detaje të mostrës së marrë në studim paraqiten në tab.1

Intervistimi i drejtpërdrejtë është realizuar me anë të pyetësorë specifike për secilin grup. Për drejtuesit e shkollave është synuar të mblidhet informacion rreth informimit të tyre mbi çështjet e mjedisit, kualifikime në këtë fushë dhe planifikimit në planin vjetor të shkollës të veprimtarive me objektiva të edukimit mjedisor. Për mësuesit është synuar vlerësimi i njohjes së rolit të mësuesit në lidhjen e koncepteve me elementët e natyrës dhe zbatimit të tyre me nxënësit. Tek nxënësit është vlerësuar formimi bazë mjedisor, perceptimi i tyre mbi tematikat mjedisore të zhvilluara në shkollë dhe shkalla e lidhjes me natyrën. Së fundi, nëpërmjet intervistimit të prindërve është vlerësuar se sa mbështetet lidhja e fëmijës me natyrën në familje dhe sa mbështetet puna, që bëjnë shkolla në këtë drejtim.

Mostra e vlerësimit statistikor									Totali
Rrethi	Shkollat	Fshat /Qytet	Drejtor /N.drejt or	Mës ues	Nx. Kl. 5	Prin dër Kl. 5	Nx. Kl. 9	Prindë r Klasa 9	
<b>TIRANË</b>	1-Edit Durham 2-Sabaudin Gabrani 3-Pjetër Budi 4-J. De Rada	Qytet	7	54	122	106	113	113	<b>515</b>
<b>FIER</b>	1-Pinellopi Pirro 2-Koli Dimo	Qytet Fshat	4	21	54	53	59	59	<b>250</b>
<b>BERAT</b>	1-Zihni	Qytet	3	10	57	57	64	64	<b>255</b>

	Toska 2-Fushë- Peshtan	Fshat							
<b>MAT</b>	1-31 Korriku 2-Haxhi Lata	Qytet Fshat	2	21	48	46	59	50	<b>226</b>
<b>ELBASAN</b>	1-Sule Harri 2-Ali Agjahu 3-Europa	Qytet Qytet Fshat	6	30	100	96	98	94	<b>424</b>
<b>LIBRAZH D</b>	1-Vilson Blloshmi 2- Rrajcë	Qytet Fshat	4	20	25	25	25	25	<b>124</b>
<b>PEQIN</b>	1-Adem Bedalli 2-Pajovë	Qytet Fshat	2	10	25	21	27	26	<b>111</b>
<b>BULQIZË</b>	1-Shefqet Tançi 2-Asllan Keta	Qytet Fshat	4	31	46	43	52	46	<b>222</b>
<b>SKRAPA R</b>	1- Kahreman Ylli 2-Riza Shahini	Qytet Fshat	4	12	37	33	40	40	<b>166</b>
<b>KUÇOVË</b>	1-Dalip Bakiu 2-18 Tetori	Fshat Qytet	4	22	47	46	45	43	<b>207</b>
<b>Totali</b>			<b>40</b>	<b>231</b>	<b>561</b>	<b>526</b>	<b>582</b>	<b>560</b>	<b>2500</b>

**Tabela. 1:** Shpërndarja gjeografike dhe ajo ndërmjet shkollave e grupit të intervistuar në këtë studim

Për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve të vlerësimit me pyetësor janë përdorur programet Microsoft office Excel (2007) dhe IBM SPSS Statistics version 20. Të dhënat janë paraqitur si %. Për krahasimin e përqindjeve është përdorur testi Chi-Square goodness-of-fit. Frekuenca minimale e pritshme për çdo rast ishte  $> 5$ . Për të gjithë testet statistikore që janë zhvilluar, ndryshimet janë konsideruar statistikisht të besueshme për çdo  $p < 0.05$ . Baza e të dhënave e ngritur për këtë përpunim është e hapur për shtimin e variablave të tjerë krahasimi dhe detajime të mëtejshme përpunimi në shërbim të gjetjeve sa më të zbatueshme dhe efektive për vendit tonë.

U analizuan të gjitha tekstet mësimore të Arsimit të Mesëm të Ulët klasa 1-9, të cilat janë përzgjedhur sipas katalogut të teksteve shkollore për vitin 2014 – 2015 të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS) (<https://app.box.com/s/nbye33102k8e0cfv6nj0>) duke marrë për bazë tekstin e parë më të shitur të katalogut, për lidhjen e tyre me natyrën sipas organizimit të të mësuarit në tre plane: të mësuarit rreth natyrës dhe mjedisit, të mësuarit në natyrë dhe mjedis dhe të mësuarit për natyrën dhe mjedisin. Analiza e teksteve është mbështetur në teknikën e interpretimit objektiv të gjetjeve, përmes përdorimit të metodave të besueshme të kërkimit.


Secila temë është quajtur e pranishme në tekstin mësimor nëse ajo përfaqësohet me koeficientin 1 në tabelën e vlerësimit të teksteve. Kjo do të thotë, që tema mjedisore duhet të jetë e përfaqësuar plotësisht në secilin mësim: në përmbajtje, aparat didaktik dhe ilustrime.

Janë marrë në konsideratë edhe gjetjet në tekstet mësimore që në mënyrë të drejtpërdrejtë (projekt detyra (Dimitriou, Georgopoulos, & Birbili 2008; Larixhani & Yeshodhara 2008; Liarakou, Bazigou, Flogaitis, & Daskolia 2006) punë e pavarur, punë laborator, detyra shtëpie) apo të tërthortë (figura dhe ilustrime, mbledhje informacioni, biseda me të afërmit) trajtonin elementë, të cilët mund t'i lidhnin nxënësit me natyrën.

## **Rezultatet e studimit**

### **Analiza e teksteve dhe programeve në ruajtjen e lidhjes me natyrën**

Janë shqyrtuar 86 programe të të gjitha lëndve të Arsimit të Mesëm të Ulët klasa 1-9 në lidhje me ruajtjen dhe zhvillimin e lidhjes me natyrën. Studimi ka gjetur se 30 nuk i përfshijnë objektivat e edukimit mjedisor, 34 i përfshijnë në mënyrë të drejtë për drejtë këto objektiva, dhe 22 prej tyre nuk i kanë në fokus të veçantë, por i përfshijnë ato në mënyrë të tërthortë. Këto objektiva janë të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë kryesisht në programet e klasave 3, 4, 7, dhe 8. Ndërkohë, programet lëndore, të cilat nuk përfshijnë objektivat e edukimit mjedisor, kanë një tendencë rritjeje nga klasat më të ulëta në ato më të larta, duke përjashtuar klasën e 4 dhe 7. (Graf.1)




**Grafik 1:** Përfshirja e objektivave të Edukimit Mjedisor në programet lëndore

Programet ku evidentohen më shumë objektiva të elementëve mjedisorë dhe lidhja me natyrën janë lëndët “Dituri Natyre” dhe “Biologji”.

Programi i lëndës “Dituri Natyre” i klasës së 4-të zhvillon më shumë njohuritë dhe kuptimin e aspekteve biologjike përmes veprimtarive shkencore dhe u jep nxënësve mundësinë të zbulojnë lidhjet e varësisë ndërmjet botës së gjallë dhe mjedisit, të nxisin kuriozitetin dhe të zhvillojnë interesin për botën që i rrethon, të ndërgjegjësohen për të bashkëvepruar me mjedisin në mënyrë të përgjegjshme dhe konsensuale, të shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit (Instituti i Kurrikulave dhe Standarteve, 2006).

Programi i lëndës “Biologji” i klasës së 6-të, (Instituti i Kurrikulave dhe Standarteve, 2005), trajton më tepër lidhjen e nxënësve me natyrën, realizon përdorimin e koncepteve shkencore në situata të jetës së përditshme duke mundësuar që nxënësit të përftojnë sjellje për të bërë zgjedhje për një jetë të shëndetshme (ISP, 2004), të vlerësojnë si të dobishme dijet dhe përvojat vetjake për rritjen e respektit për natyrën dhe krijimin e marrëdhënieve harmonike nxënës - natyrë.




**Grafik 2.** Paraqitje grafike e lëndëve ku përfitohet më shumë informacion mjedisor dhe lidhje me natyrën bazuar në programet mësimore

Nga analiza e teksteve mësimore klasa 1-9 u konstatua se vetëm 11 tekste mësimore, nga 86 në total, trajtojnë tematika mjedisore brenda objektivave të edukimit mjedisor, duke përfaqësuar kështu vetëm 13% të të gjitha teksteve. Në këto tekste paraqitet lidhja me natyrën nëpërmjet temave të projekteve dhe punëve praktike, nëpërmjet figurave të ndryshme mbi natyrën, detyra shtëpie, të cilat nxitin diskutimet mbi varësinë ndaj mjedisit, marrjen e vendimeve, biseda me familjarët për gjendjen e mjedisit dhe natyrës përgjatë viteve dhe biseda me një specialist mjedisi për njohjen e ligjeve mjedisore.

Rezultatet e mëposhtëme paraqesin të dhënat mbi vlerësimin e shkallës së lidhjes së nxënësve me natyrën të grumbulluara nga pyetësorët e plotësuar në 23 shkolla të Arsimit të Mesëm të Ulët. Në vijim paraqiten rezultatet e përfutura nga analizimi i disa prej pyetjeve të pyetësorëve:


❖ **Sa i rëndësishëm është natyra dhe mjedisi për ju?** Për nxënësit e klasës 5-të dhe të 9-të të cilët ishin grupet e synuar për këtë pyetje mjedisi ishte shumë i rëndësishëm. Mund të pohojmë se mostra e këtij vlerësimi përfaqëson individë të interesuar për mjedisin (Graf.3).





**Grafik 3:** Vlerësimi në % i rëndësisë së natyrës dhe mjedisit në mostrën e vlerësuar


❖ **Sa shëtisin fëmijët në natyrë?** Nxënësit banues të zonave urbane praktikojnë më shumë daljet në natyrë me familjen sesa nxënësit banues të zonave rurale të cilët natyrën e kanë pjesë të përditshmërisë së tyre. Më shumë së gjysma e nxënësve (55.8%) përzgjedhën se shëtisin “shpesh” në natyrë, 10.3% e tyre u përgjigjën “çdo ditë” dhe 28.7% “rrallë”. Midis dy grupeve (nxënës klasa 5 dhe nxënës klasa 9) nuk ka ndryshime në përgjigje, përkundrazi ato janë shumë të ngjashme me një nivel besimi  $p < 0.05$  graf. 4.



**Grafik 4:** Të dhënat në % se sa shëtisin në natyrë nxënësit e klasës 5-të dhe 9-të

❖ **A keni realizuar veprimtari mjedisore në shkollën tuaj?** Nxënësit e klasës 5-të dhe 9-të pothuajse 100% e tyre u përgjigjën pozitivisht. Prindërit e këtyre nxënësve u pyetën nëse shkolla e fëmijës së tyre organizon aktivitete mjedisore dhe 87.4% e tyre e pohuan këtë fakt duke mbështetur alternativat e mësuesve dhe nxënësve. Ndër aktivitetet më të zakonshme mjedisore të zhvilluara në shkollë, fëmijët përmendin festimin e ditëve mjedisore (Dita e


Mjedisit, Dita e Tokës, Dita e Ujit, Dita pa Makina, Dita e Biodiversitetit), aktivitete gjelbërimi si mbjellje pemësh, ekskursione në natyrë (Graf. 5).



**Graf 5:** A realizojnë shkollat veprimtari mjedisore?

❖ **Cilat janë mjediset natyrore të frekuentuar më shumë nga nxënësit?**

Për nxënësit e klasave 5-të dhe 9-të mjediset bregdetare janë vendi më i parapëlqyer më shumë për t'u frekuentuar (52.3%). Frekuentimi i zonave malore, pyjeve dhe lëndinave parapëlqehet nga 35.7% e nxënësve dhe vetëm 12% parapëlqejnë të frekuentojnë liqenin (Graf. 6).



**Grafik 6.** Mjedisit i parapëlqyer për tu frekuentuar më shumë nga nxënësit (në %)

### **Përfundime**

Programet lëndore dhe tekstet për arsimin e mesëm të ulët kanë tendencë të përfshijnë objektivat dhe elementët e edukimit mjedisor. Nuk vihet re një tendencë e përcaktuar në shpërndarjen e përfshirjes apo mos përfshirjes së elementëve mjedisorë në programet lëndore brenda të njëjtës lëndë.

Nxënësit marrin më shumë njohuri mbi mjedisin dhe lidhjen me natyrën në klasën e 6-të. Tema mjedisore më e trajtuar në tekstet mësimore është “Gjendja mjedisore”, e cila zhvillohet në 128 orë mësimi duke filluar nga klasa 1-9.

Lëndët që trajtojnë më shumë tema mjedisore dhe të lidhjes me natyrën përgjatë zhvillimit të orëve të tyre janë: Dituria e Natyrës (23%), Biologjia (13%), Gjeografia (12%) dhe Edukata Shoqërore (10%). Megjithatë, lëndë si Kimia apo Gjuha e Huaj janë lëndë të cilat kanë një frymë mjedisore, e cila ndihet në formën e trajtimit të çdo mësimi, pavarësisht se ai nuk përmban elementë të matshëm dhe konkretë të objektivave të edukimit mjedisor.

Mësuesit, drejtorët, nxënësit e shkollave dhe prindërit të marrë në analizë në këtë vlerësim, përfaqësojnë një komunitet të interesuar për çështjet mjedisore, të cilët janë të prirur të përkrahin zhvillimin e sjelljeve pro mjedisore në mënyrë që kontakti i drejtpërdrejtë i nxënësve me natyrën të jetë rruga më e mirë e forcimit të kësaj lidhje. Ato pohojnë se metodat më efikase që nxisin dhe përforcojnë lidhjen me natyrën janë vrojtimi dhe ekskursionet mësimore.

Mësuesit parashtrojnë një sërë kufizimesh për të nxitur më tej lidhjen natyrë-nxënës përmes shkollës si mungesat e burimeve, programet arsimore të mbingarkuara, tërheqjen prej teknologjisë digjitale dhe përparësia e ulët për edukimin mjedisor në shkolla.

Në shkolla realizohen aktivitete të ndryshme mjedisore, kryesisht festimi i ditëve mjedisore dhe mbjellje fidanësh, që i bën nxënësit të jenë më të ndjeshëm dhe më të ndërgjegjshëm për problemet e mjedisit human dhe natyror, mbi ndikimin e individëve mbi mjedisin. Organizimi më i mirë dhe dhënia e mesazheve të drejtpërdrejta për të nxitur lidhjen e nxënësve me natyrën do të rrisë më tej efikasitetin e këtyre veprimtarive.

Mbështetur në trajtimin e elementëve të edukimit mjedisor në programet dhe tekstet mësimore të arsimit të mesëm të ulët klasa 1-9, rekomandojmë sjelljen e edukimit mjedisor jo më si lëndë krosskurrikulare por të zhvillohet lëndë më vete si forma më e përshtatshme për realitetin e sistemit arsimor shqiptar.

## Literatura

Bajrami, D., Zenelaj, F. (2008): Libër mësuesi për tekstin Biologji dhe Edukim Shëndetësor 7-8-9. Botime shkollore Albas, Tiranë

Dye J.L., Johnson T. (2006): A Child's Day: 2003 (Selected Indicators of Child Well Being). Current Population Reports, pg 70-190. Washington, DC: U.S. Census Bureau

Ehrlich P., Ehrlich A. (1981): Preserving Biodiversity Just for the Beauty of Nature

Gray P. (2011): The decline of play and the rise of psychopathology in children and adolescents

Hofferth S. L., Sandberg J.F. (2001): Changes in American children's use of time: 1981-1997. In Owens, T. & Hofferth, S.L. (Eds.). Children at the Millennium: Where Have We Come From, Where Are We Going? Amsterdam, the Netherlands: Elsevier Science Publishers

Instituti i Kurrikulave dhe Standarteve (2007): Program mësimor për AMU. Lënda: Biologji dhe Edukim Shëndetësor

Lee F.R. (1993): Tracking leads when the young disappear; in many missing-children cases, the danger is often close to home. The New York Times. Article published February 8, 1993

Levin D., Arafeh S. (2002): The Digital Disconnect: The Widening Gap Between Internet-Savvy Students and Their Schools. American Institutes for Research for The Pew Internet & American Life Project. Washington, DC

Louv R. (1990): Childhood's Future. New York, NY: Anchor Books

Louv R. (2005): Last Child in the Woods: Saving our Children from Nature-Deficit Disorder, Chapel Hill, N.C.: Algonquin

Migliarese N. L. (2008): Researching the Child - Nature Connection. California State Parks

Molles Manuel C. (1999): Ecology: Concepts and Applications. Boston, ISBN 0-07-042716-X

Pape A. (2010): Screen time linked to psychological problems in children. University of Bristol

Ryan R. (2010): Spending time in nature makes people feel more alive. Journal of Environmental Psychology

RSPB (2013): Connecting with nature: Finding out how connected to nature the UK's children are

Sanderson E. (2009): Cities in Nature's Network

Taylor P. (2005): Teens more tech savvy than ever before. Financial Times. 6.12.2005

Instituti i Studimeve Pedagogjike (2004): Korniza e re kurrikulare për arsimin parauniversitar, Tiranë